



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 154

13 shtator

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr. 8299 datë 4.9.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 7035
Dekret nr. 8300 datë 5.9.2013	Për emërimin e kryetarit të Akademisë së Shkencave 7035
Dekret nr. 8304 datë 11.9.2013	Për emërimin e Këshillit të Ministrave 7036
Dekret nr. 8305 datë 11.9.2013	Për emërim Zëvendëskryeministri 7037
Dekret nr. 8306 datë 11.9.2013	Për emërim Ministri 7037
Dekret nr. 8307 datë 11.9.2013	Për emërim Ministri 7038
Dekret nr. 8308 datë 11.9.2013	Për emërim Ministri 7038
Dekret nr. 8309 datë 11.9.2013	Për emërim Ministri 7039
Dekret nr. 8310 datë 11.9.2013	Për emërim Ministri 7039
Dekret nr. 8311 datë 11.9.2013	Për emërim Ministri 7040
Dekret nr. 8312 datë 11.9.2013	Për emërim Ministri 7040

Dekret nr. 8313 datë 11.9.2013	Për emërim Ministri	7041
Dekret nr. 8314 datë 11.9.2013	Për emërim Ministri	7041
Dekret nr. 8315 datë 11.9.2013	Për emërim Ministri	7042
Dekret nr. 8316 datë 11.9.2013	Për emërim Ministri	7042
Dekret nr. 8317 datë 11.9.2013	Për emërim Ministri	7042
Dekret nr. 8318 datë 11.9.2013	Për emërim Ministri	7043
Dekret nr. 8319 datë 11.9.2013	Për emërim Ministri	7043
Dekret nr. 8320 datë 11.9.2013	Për emërim Ministri	7044
Dekret nr. 8321 datë 11.9.2013	Për emërim Ministri	7044
Dekret nr. 8322 datë 11.9.2013	Për emërim Ministri	7045
Dekret nr. 8323 datë 11.9.2013	Për emërim Ministri	7045
Dekret nr. 8324 datë 11.9.2013	Për emërim Ministri	7046
Vendim i KM nr. 742, datë 5.9.2013	Për lejimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për kryerjen e procedurës së prokurimit për shërbimin e internetit në shkollat dhe institucionet e arsimit parauniversitar dhe botimit të çdo lloj njoftimi prokurimi për këtë shërbim	7046
Vendim i KM nr. 743, datë 5.9.2013	Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve “Master profesional”, me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2013 – 2014	7047
Vendim i KM nr. 744, datë 5.9.2013	Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve, me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, për vitin akademik 2013 – 2014	7052

DEKRET
Nr. 8299, datë 4.9.2013

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|-----------------------------------|---|
| 1. Ibrahim Fikret Aktoz | 12. Servet Jusuf Berisha (Muhagjeri) |
| 2. Selen Şadi Aktoz | 13. Tonin Franco Andracchio |
| 3. Ismail Ibrahim Aktoz | 14. Vaska Risto Vangjeli (Badjukov) |
| 4. Ibrahim Ibrahim Aktoz | 15. Rania Riad El Samad |
| 5. Dardan Islam Velija | 16. Nina Vasilij Dmitrieva (Vjerevkina) |
| 6. Naz Beqir Feka | 17. Luciano Erasmo Cirillo |
| 7. Vlora Rrahim Salla (Shala) | 18. Emine Mustafa Bruçaj (Mersin) |
| 8. Zaravshon Saidnuhrdin Zuhurova | 19. Bajram Zaim Jusufi |
| 9. Lurde Pala Ramaj | 20. Afërdita Sebastian Koliqi (Pera) |
| 10. Vinko Nuo Nikprelaj | 21. Sheremet Adem Ademi |
| 11. Caludio Bruno Ferrari | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8300, datë 5.9.2013

PËR EMËRIMIN E KRYETARIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE

Në mbështetje të neneve 92 shkronja “g” dhe 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 11 pika 1 të ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Akademisë së Shkencave,

DEKRETOJ:

Neni 1

Akademiku Muzafer Korkuti emërohet Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8304, datë 11.9.2013

PËR EMËRIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 93, 96 dhe 98 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Emërimin e Këshillit të Ministrave me këtë përbërje:

1. Zoti Edi Rama, Kryeministër
2. Zoti Niko Peleshi, Zëvendëskryeministër
3. Zoti Ditmir Bushati, Ministër i Punëve të Jashtme
4. Zonja Mimi Kodheli, Ministër i Mbrojtjes
5. Zoti Saimir Tahiri, Ministër i Punëve të Brendshme
6. Zonja Klajda Gjasha, Ministër i Integrimit Evropian
7. Zoti Shkëlqim Cani, Ministër i Financave
8. Zoti Edmond Haxhinasto, Ministër i Transportit dhe Infrastrukturës
9. Zonja Eglantina Gjermeni, Ministër i Zhvillimit Urban dhe Turizmit
10. Zoti Arben Ahmetaj, Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
11. Zonja Lindita Nikolla, Ministër i Arsimit dhe Sportit
12. Zoti Nasip Naço, Ministër i Drejtësisë
13. Zonja Mirela Kumbaro Furxhi, Ministër i Kulturës
14. Zoti Erion Veliaj, Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
15. Zoti Damian Gjijnuri, Ministër i Energjisë dhe Industrisë
16. Zoti Edmond Panariti, Ministër i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
17. Zoti Ilir Beqja, Ministër i Shëndetësisë
18. Zoti Lefter Koka, Ministër i Mjedisit
19. Zonja Milena Harito, Ministër Shteti për Inovacionin dhe Administratën Publike
20. Zoti Blendi Çuçi, Ministër Shteti për Çështjet Vendore
21. Zoti Ilirjan Celibashi, Ministër Shteti për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8305, datë 11.9.2013

PËR EMËRIM ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Niko Peleshi emërohet Zëvendëskryeministër i Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8306, datë 11.9.2013

PËR EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Ditmir Bushati emërohet Ministër i Punëve të Jashtme.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani



DEKRET
Nr. 8307, datë 11.9.2013

PËR EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Mimi Kodheli emërohet Ministër i Mbrojtjes.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8308, datë 11.9.2013

PËR EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Saimir Tahiri emërohet Ministër i Punëve të Brendshme.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8309, datë 11.9.2013

PËR EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Klajda Gjoshaj emërohet Ministër i Integrimit Evropian.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8310, datë 11.9.2013

PËR EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Shkëlqim Cani emërohet Ministër i Financave.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani



DEKRET
Nr. 8311, datë 11.9.2013

PËR EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Edmond Haxhinasto emërohet Ministër i Transportit dhe Infrastrukturës.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8312, datë 11.9.2013

PËR EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Eglantina Gjermani emërohet Ministër i Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8313, datë 11.9.2013

PËR EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Arben Ahmetaj emërohet Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8314, datë 11.9.2013

PËR EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Lindita Nikolla emërohet Ministër i Arsimit dhe Sportit.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani



DEKRET
Nr. 8315, datë 11.9.2013

PËR EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Nasip Naço emërohet Ministër i Drejtësisë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8316, datë 11.9.2013

PËR EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Mirela Kumbaro Furxhi emërohet Ministër i Kulturës.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8317, datë 11.9.2013

PËR EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Erion Veliaj emërohet Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 8318, datë 11.9.2013

PËR EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Damian Gjijnuri emërohet Ministër i Energjisë dhe Industrisë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 8319, datë 11.9.2013

PËR EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Edmond Panariti emërohet Ministër i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 8320, datë 11.9.2013

PËR EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Ilir Beqja emërohet Ministër i Shëndetësisë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 8321, datë 11.9.2013

PËR EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Lifter Koka emërohet Ministër i Mjedisit.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8322, datë 11.9.2013

PËR EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Milena Harito emërohet Ministër Shteti për Inovacionin dhe Administratën Publike.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8323, datë 11.9.2013

PËR EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Bledi Çuçi emërohet Ministër Shteti për Çështjet Vendore.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani



DEKRET
Nr. 8324, datë 11.9.2013

PËR EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Ilirjan Celibashi emërohet Ministër Shteti për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 742, datë 5.9.2013

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS PËR KRYERJEN E
PROCEDURËS SË PROKURIMIT PËR SHËRBIMIN E INTERNETIT NË SHKOLLAT
DHE INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE BOTIMIT TË ÇDO LLOJ
NJOFTIMI PROKURIMI PËR KËTË SHËRBIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, dhe të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2013”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për kryerjen e procedurës së prokurimit për shërbimin e internetit në shkollat dhe institucionet e arsimit parauniversitar dhe botimit të çdo lloj njoftimi prokurimi për këtë shërbim me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit, për vitin 2013, brenda datës 31 dhjetor 2013. Brenda këtij afati përfshihen lidhja e kontratës përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministra e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 743, datë 5.9.2013

**PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË INSTITUCIONET
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE “MASTER
PROFESIONAL”, ME KOHË TË PJESSHME, PËR VITIN AKADEMIK 2013 – 2014**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 24, 34, 35, 36 e 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 9.4.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ligjit nr. 8626, datë 4.7.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.2.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, dhe të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë për programet e studimeve të ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2013 – 2014, të jenë 4710, të ndara, si më poshtë vijon:

- a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional”, me kohë të pjesshme, për kandidatët brenda territorit të vendit 4220;
- b) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional”, me kohë të pjesshme, për kandidatët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit 200;
- c) Kuotat për transferimin e studimeve 100;
- ç) Kuotat për të huajt 50;
- d) Kuotat për personat që nuk shikojnë 20;
- dh) Kuotat për romët dhe ballkano-egjiptianët 20;
- e) Kuotat për ish-të përndjekurit politikë 100.

2. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, sipas shkronjës “a”, të pikës 1 të këtij vendimi, sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, pasqyrohen në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Kuotat e pranimeve për programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, të përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij vendimi, të cilat ndahen ndërmjet kandidatëve shqiptarë jashtë kufijve të vendit, nga Republika e Kosovës, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbështetur edhe në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja aplikojnë direkt në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

4. Kuotat e pranimeve për transferimin e studimeve të ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bazuar në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.



Kriteret për transferim përcaktohen nga institucionet publike të arsimit të lartë dhe bëhen publike paraprakisht.

5. Kuotat e pranimi për shtetasit e huaj që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në ciklin e dytë të studimeve “Master profesional”, me kohë të pjesshme, sipas shkronjës “ç” të pikës 1 të këtij vendimi, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas marrëveshjeve dy- apo shumëpalëshe ndërmjet vendeve.

6. Kuotat e pranimeve, sipas shkronjës “d” të pikës 1 të këtij vendimi, për kandidatët me statusin e personave që nuk shikojnë, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbi bazën e listës së hartuar nga Shoqata Kombëtare e të Verbërve.

7. Kuotat e pranimeve, sipas shkronjës “dh” të pikës 1 të këtij vendimi, për romët dhe ballkano-egjiptianët, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbi bazën e listës së hartuar të shoqatave respektive, Shoqatës Kombëtare të Romëve dhe Shoqatës Kombëtare të Ballkano-Egjiptianëve.

8. Kuotat e pranimeve, sipas shkronjës “e” të pikës 1 të këtij vendimi, për ish-të përndjekurit politikë, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbi bazën e listës së hartuar nga Instituti i Integritetit të të Përndjekurve Politikë dhe plotësimit të kriterëve të vendosura nga institucionet publike të arsimit të lartë.

9. Çdo program studimi i ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, funksionon në vitin e parë për vitin akademik 2013 – 2014, në rast se atë e ndjekin, të paktën, 10 studentë.

10. Institucionet publike të arsimit të lartë përcaktojnë kriteret e pranimi të kandidatëve të ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, dhe i bëjnë publike paraprakisht.

11. Tarifat e shkollimit për çdo kredit, për studentët që do të regjistrohen në vitin e parë, për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, në vitin akademik 2013–2014, përcaktohen në tabelën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

12. Tarifat e përgjithshme të shkollimit për studentët që do të regjistrohen në vitin e parë, për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, në vitin akademik 2013 – 2014, përcaktohen në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

13. Pagesa e tarifës bëhet me këste të përcaktuara nga institucioni publik i arsimit të lartë. Pas përfundimit të kohëzgjatjes normale të programit të studimit, studentët, të cilët nuk e kanë përfunduar ende programin përkatës, paguajnë vetëm tarifën për kredit, sipas tarifës së vitit, në të cilin zhvillon provimin/provimet e lëndëve të prapambetura.

14. Kandidatët që do të fitojnë të drejtën në një program studimi të ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2013 – 2014, dhe që u përkasin shtresave sociale, si: personat që nuk shikojnë/nuk dëgjojnë, invalidët e punës dhe fëmijët e tyre, invalidët paraplegjikë e tetraplegjikë dhe fëmijët e tyre, jetimët, studentët të cilëve njëri nga prindërit u është ndarë nga jeta dhe familjet e tyre përfitojnë ndihmë ekonomike nga njësitë e qeverisjes vendore si “familje në nevojë”, fëmijët romë, ballkano-egjiptianë, fëmijët nga prindër të dënuar politikë me heqje lirie, fëmijë të policëve e të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të rënë ose të plagosur për shkak të detyrës, të prekurit nga sëmundja HIV-AIDS, paguajnë një kuotë në masën 50% të tarifës së shkollimit.

15. Shtetasit e huaj që do të vazhdojnë studimet e ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë, u nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur, me marrëveshje ndërshtetërore, është parashikuar ndryshe.

16. Studentët që përfitojnë nga kuotat e përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, u nënshtrohen tarifës së shkollimit të programit përkatës të studimit që ata kanë kërkuar.

17. Rishpërndarja e kuotave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat mbeten të përcaktuara, bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në bashkëpunim me institucionet publike të arsimit të lartë.

18. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES (TABELA Nr.1)

KUOTAT DHE TARIFAT, CIKLI I DYTË "MASTER PROFESIONAL" ME KOHË TË PJESSHME, PËR VITIN
AKADEMIK 2013-2014

UNIVERSITETI	FAKULTETI	ID_Pro gramit	EMËRTIMI I PROGRAMIT	Kuotat per studentët Shqiptarë	Tarifa për Kredit (në lekë)	Tarifa totale për 90 Kredite (në lekë)
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë	1	Mësuesi AM në Histori	120	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë	2	Mësuesi AM në Gjeografi	120	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë	3	Mësuesi AM në Gjuhë-Letërsi	120	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	4	Mësuesi AM në Biologji	40	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Shkencave Sociale	5	Pedagogji e Specializuar Sociale	50	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë	6	Administrim-Biznes	40	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë	7	Administrim-Publik	40	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë	8	Marketing	40	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë	9	Menaxhim Turizmi	40	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë	10	Financë	100	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë	11	Kontabilitet	40	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë	12	Administrim Biznesi në Sipërmarrje	40	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë	13	Studime Ekonomike Evropiane	40	832	74,880
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Fakulteti i Infermierisë	14	Menaxhim Infermieror	130	832	74,880
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Fakulteti i Infermierisë	15	Mami	40	832	74,880
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Fakulteti i Infermierisë	16	Teknikë Laboratori	40	832	74,880
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Fakulteti i Infermierisë	17	Fizioterapi	20	832	74,880
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Fakulteti i Infermierisë	18	Imazheri	20	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Drejtësisë	19	E Drejtë Civile	100	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Drejtësisë	20	E Drejtë Penale	100	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Drejtësisë	21	E Drejtë Publike	100	832	74,880
Univ. Politeknik Tiranë	Fakulteti i Inxhienerisë Mekanike	22	Menaxhim i Trafikut dhe Sigurisë	30	832	74,880
Univ. Politeknik Tiranë	Fakulteti i Inxhienerisë Mekanike	23	Inxhinieri Tekstili dhe Mode	15	832	74,880
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	24	Menaxhim Mjedisit	60	832	74,880
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	25	Menaxhim i Qëndrueshëm Rural dhe Mjedisit	60	832	74,880
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	26	Teknologjitë e Kultivimit të Bimëve	40	832	74,880
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	27	Teknologjitë e Avancuara në Hortikulturë	40	832	74,880
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	28	Mbrojtja e Bimëve dhe Fitofarmacia	40	832	74,880
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	29	Biznes Blegtoral	40	832	74,880
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	30	Arkitekturë Peisazhi	35	832	74,880
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	31	Menaxhim i Ndërmarrjeve dhe Agrobiznesit	150	832	74,880
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	32	Ekonomi dhe Politikë Agrare	150	832	74,880
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	33	Financë-Kontabilitet	150	832	74,880
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bioeknologjisë dhe Ushqimit	34	Cilësia dhe Siguria Ushqimore	110	832	74,880
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Mjekësisë Veterinare	35	Shëndeti Publik Veterinar	30	1,040	93,600

Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Mjekësisë Veterinare	36	Veterinari Klinike	30	1,040	93,600
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	Fakulteti Edukimit dhe Filologjisë	37	Mësuesi për Ciklet të Ulët	100	832	74,880
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	Fakulteti Edukimit dhe Filologjisë	38	Mësimdhënie për Mësuesit e Shkollave Profesionale	80	832	74,880
Univ. "I. Qemali" Vlorë	Fakulteti i Ekonomisë	39	Administrim Publik	100	832	74,880
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	40	Psikologji e Shëndetit	70	832	74,880
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Ekonomisë	41	Trashëgimi Kulturore dhe Menaxhim Turizmi	60	832	74,880
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Ekonomisë	42	Financë Bankë	60	832	74,880
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Ekonomisë	43	Administrim-Biznes	60	832	74,880
Univ. "E. Çabej" Gjirokastrë	Fakulteti Edukimit dhe Shkencave Shoqërore	44	Mësuesi AM në Matematikë-Fizikë me profil minor "Aftësim Teknologjik"	60	832	74,880
Univ. "E. Çabej" Gjirokastrë	Fakulteti Edukimit dhe Shkencave Shoqërore	45	Mësuesi AM në Biologji-Kimi me profil minor "Edukim Mjedisor e Tolerancë"	40	832	74,880
Univ. "E. Çabej" Gjirokastrë	Fakulteti Edukimit dhe Shkencave Shoqërore	46	Mësuesi AM në Gjuhë-Letërsi me profil minor "Gjuhë Italiane"	75	832	74,880
Univ. "E. Çabej" Gjirokastrë	Fakulteti Edukimit dhe Shkencave Shoqërore	47	Mësuesi AM në Histori-Gjeografi me profil minor "Edukate Shoqërore"	100	832	74,880
Univ. "E. Çabej" Gjirokastrë	Fakulteti Edukimit dhe Shkencave Shoqërore	48	Kontabilitet-Financë	100	832	74,880
Univ. "E. Çabej" Gjirokastrë	Fakulteti Edukimit dhe Shkencave Shoqërore	49	Administrim Publik	100	832	74,880
Univ. "E. Çabej" Gjirokastrë	Fakulteti Edukimit dhe Shkencave Shoqërore	50	Turizëm	55	832	74,880
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	51	Psikologji në Institucione	60	832	74,880
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	52	Punë Sociale me Femijët dhe Familjen	60	832	74,880
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	53	Mësuesi në Matematikë-Fizikë me profil minor Informatikë	40	832	74,880
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	54	Mësuesi në Matematikë-Informatikë me profil minor Fizikë	40	832	74,880
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	55	Mësuesi Biologji-Kimi, me profil minor "Edukim Shëndetësor dhe Mjedisor"	60	832	74,880
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	56	Mësuesi në Gjuhë Shqipe e Letërsi	60	832	74,880
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	57	Mësuesi në Histori-Gjeografi me profil minor Edukatë Qytetare	50	832	74,880
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	58	Mësuesi në Edukatë Qytetare-Histori me profil minor Gjeografi	60	832	74,880
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	59	Mësuesi në Edukatë Qytetare-Gjeografi me profil minor Histori	60	832	74,880
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	60	Mësuesi në Gjuhë Italiane, me profil minor "Gjuhë Shqipe"	40	832	74,880
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	61	Mësuesi në Gjuhë Angleze, me profil minor "Gjuhë Shqipe"	40	832	74,880
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	62	Mësuesi në Gjuhë Frengje me profil minor Gjuhë Shqipe	40	832	74,880
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	63	Mësuesi në Gjuhë Gjermane, me profil minor në "Gjuhë Shqipe"	40	832	74,880
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	64	Drejtim dhe Administrim Arsimit	80	832	74,880
Univ. Sporteve Tiranë	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes	65	Mësuesi i Edukimit Fizik	70	832	74,880
			TOTALI	4220		



VENDIM
Nr. 744, datë 5.9.2013

**PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË INSTITUCIONET
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE, ME KOHË
TË PLOTË, “MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER I SHKENCAVE”/“MASTER I
ARTEVE TË BUKURA”, PËR VITIN AKADEMIK 2013 – 2014**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 24, 34, 35, 36 e 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 9.4.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ligjit nr. 8626, datë 4.7.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligji nr. 7889, datë 14.2.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, dhe të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë për programet e studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master profesional”, për vitin 2013 – 2014, të jenë 10 860 gjithsej. Këto kuota të ndahen, si më poshtë vijon:

- a) Kuotat e pranimeve për kandidatët brenda vendit për programet e studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master profesional” 10 170;
- b) Kuotat e pranimeve për kandidatët nga trojet për programet e studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master profesional” 400;
- c) Kuotat për programe të dyta studimi 100;
- ç) Kuotat për transferimin e studimeve 100;
- d) Kuotat për personat që nuk shikojnë 20;
- dh) Kuotat për romët/ballkano-egjiptianët 20;
- e) Kuota për shtetas të huaj 50.

2. Kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë për programet e studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, për vitin 2013 – 2014, të jenë 9492 gjithsej. Këto kuota të ndahen si më poshtë vijon:

- a) Kuotat e pranimeve për kandidatët brenda vendit për programet e studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura” 8802;
- b) Kuotat e pranimeve për kandidatët nga trojet për programet e studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura” 400;
- c) Kuotat për programe të dyta studimi 100;
- ç) Kuotat për transferimin e studimeve 100;
- d) Kuotat për personat që nuk shikojnë 20;
- dh) Kuotat për romët/ballkano-egjiptianët 20;
- e) Kuota për shtetas të huaj 50.

3. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit, me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, të pasqyruara përkatësisht në shkronjat “a” të pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, shpërndahen sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë dhe pasqyrohen përkatësisht në tabelën nr. 1 dhe tabelën nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Kuotat e pranimeve për programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, të pasqyruara përkatësisht në shkronjat “b” të pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, të cilat ndahen ndërmjet kandidatëve nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatëve shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, duke marrë parasysh edhe kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja aplikojnë direkt në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

5. Kuotat e pranimeve për një program të dytë studimi dhe transferimi i studimeve për programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, të përcaktuara përkatësisht në shkronjat “c” dhe “ç” të pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bazuar në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

Pranimet për programe të dyta studimi dhe transferimet e studimeve në numrin përkatës të kuotës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës bëhet nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, sipas kriterëve të përcaktuara në aktet nënligjore, statutet dhe rregulloret e tyre, të bëra publike paraprakisht.

6. Kuotat e pranimeve për programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, të pasqyruara përkatësisht në shkronjat “d” të pikave 1 dhe 2 për personat që nuk shikojnë, ndahen për kandidatët me statusin e personave që nuk shikojnë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbi bazën e listës së hartuar nga Shoqata Kombëtare e të Verbërve.

7. Kuotat e pranimeve për programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, për romët dhe ballkano-egjiptianët, të pasqyruara përkatësisht në shkronjat “dh” të pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbi bazën e listës së hartuar nga shoqatat respektive, përkatësisht, Shoqata Kombëtare e Romëve dhe Shoqata Kombëtare e Ballkano-Egjiptianëve.

8. Kuotat e pranimit për shtetasit e huaj që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në ciklin e dytë të studimeve, me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, të pasqyruara përkatësisht në shkronjat “e” të pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Ato të shpërndahen në bazë të marrëveshjeve dy- apo shumëpalëshe midis vendeve.

9. Çdo program studimi i ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, funksionon në vitin e parë, për vitin akademik 2013 – 2014, në rast se atë e ndjekin të paktën 10 studentë, përjashtuar Universitetin e Arteve Tiranë.

10. Institucionet publike të arsimit të lartë përcaktojnë kriteret e pranimit të kandidatëve të rinj për programet e studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, për vitin akademik 2013 – 2014, dhe i bëjnë publike paraprakisht.

11. Tarifat e shkollimit për çdo kredit, për studentët që do të regjistrohen në vitin e parë, për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, në vitin akademik 2013 – 2014, pasqyrohen



përkatësisht në tabelën nr. 1 dhe tabelën nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

12. Tarifat e përgjithshme të shkollimit për studentët që do të regjistrohen në vitin e parë, për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, në vitin akademik 2013 – 2014, pasqyrohen përkatësisht në tabelën nr. 1 dhe tabelën nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

13. Pagesa e tarifës për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, bëhet me këste të përcaktuara nga institucioni publik i arsimit të lartë. Pas përfundimit të kohëzgjatjes normale të programit të studimit, studentët, të cilët nuk e kanë përfunduar ende programin përkatës, paguajnë vetëm tarifën për kredit, sipas tarifës së vitit, në të cilin zhvillon provimin/provimet, të lëndëve të prapambetura.

14. Kandidatët, që do të fitojnë të drejtën në një program studimi të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2013 - 2014 dhe që u përkasin shtresave sociale, si: personat që nuk shikojnë/personat që nuk dëgjojnë, invalidët e punës dhe fëmijët e tyre, invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe fëmijët e tyre, jetimët, studentët të cilëve njëri nga prindërit i është ndarë nga jeta dhe familjet e tyre përfitojnë ndihmë ekonomike nga njësitë e qeverisjes vendore si “familje në nevojë”, fëmijët romë, ballkano-egjiptianë, fëmijët nga prindër të dënuar politikë me heqje lirie, fëmijë të policëve e të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të rënë ose të plagosur për shkak të detyrës, të prekurit nga sëmundja HIV-AIDS, paguajnë një kuotë në masën 50% të tarifës së shkollimit.

15. Shtetasit e huaj, që do të vazhdojnë studimet e ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur, në kuadër të marrëveshje ndërshtetërore, është parashikuar ndryshe.

16. Studentët, që përfitojnë nga kuotat e përcaktuara përkatësisht në shkronjat “c” dhe “ç” të pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, u nënshtrohen tarifës së shkollimit të programit përkatës të studimit që ata kanë kërkuar.

17. Rishpërndarja e kuotave të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, të cilat mbeten të parealizuar, bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në bashkëpunim me institucionet publike të arsimit të lartë.

18. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES (TABELA Nr.1)

KUOTAT DHE TARIFAT _ CIKEL II _ MASTER PROFESIONAL _ KOHE E PLOTE _ VITI
AKADEMIK _ 2013-2014

UNIVERSITETI	FAKULTETI	ID_Pro gramit	EMËRTIMI I PROGRAMIT	Kuotat për studentët Shqiptarë 2013-2014	Tarifa për Kredit (në lekë)	Tarifa totale për 90 Kredite (në lekë)
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë	1	Mësuesi AM në Histori	130	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë	2	Mësuesi AM në Gjeografi	130	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë	3	Mësuesi AM në Gjuhë-Letërsi	130	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë	4	Arkivistikë	50	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë	5	Redaktim	60	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	6	Bioteknologji Mjedisore	40	936	84,240
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	7	Informatikë Biznesi	80	936	84,240
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	8	Inxhinieri Matematike dhe Informatike	50	937	84,334
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	9	Teknologji Informacioni	55	937	84,334
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Shkencave Sociale	10	Punë Sociale e Avancuar (2 Dejtime)	50	1,040	93,600
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Shkencave Sociale	11	Analizë e Plotikave Sociale	50	1,040	93,600
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Shkencave Sociale	12	Qeverisje dhe Politika Publike	50	1,040	93,600
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Shkencave Sociale	13	Sociologji Edukimi	40	1,040	93,600
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Shkencave Sociale	14	Administrim i Institucioneve Sociale në Sistemin e Drejtësisë	150	1,040	93,600
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Shkencave Sociale	15	Filozofi Praktike dhe Humane	50	1,040	93,600
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Shkencave Sociale	16	Këshillim Psikologjik	50	1,040	93,600
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Shkencave Sociale	17	Orientim Profesional	50	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Shkencave Sociale	18	Drejtim dhe Administrim Arsimit	50	1,040	93,600
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Shkencave Sociale	19	Pedagogji e Specializuar Sociale	50	1,040	93,600
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë	20	Administrim-Biznes	40	1,040	93,600
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë	21	Administrim-Publik	40	1,040	93,600
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë	22	Marketing	35	1,040	93,600
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë	23	Menaxhim Turizmi	30	1,040	93,600
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë	24	Financë	120	1,040	93,600
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë	25	Kontabilitet	70	1,040	93,600
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë	26	Studime Ekonomike Evropiane	40	1,040	93,600
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë	27	Sisteme Informacioni në Ekonomi	40	1,040	93,600
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë	28	Menaxhim Turizmi (Sarandë)	50	1,041	93,694
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Drejtësisë	29	E Drejtë Civile	100	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Drejtësisë	30	E Drejtë Penale	100	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Drejtësisë	31	E Drejtë Publike	100	832	74,880
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Drejtësisë	32	Biznes Law	100	832	74,880
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Fakulteti i Shëndetësisë	33	Shëndet Publik	30	1,040	93,600
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Fakulteti i Infermierisë	34	Menaxhim Infermieror	150	1,040	93,600



Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Fakulteti i Infermierisë	35	Mami	40	1,040	93,600
